

# THIRRJE PËR APLIKIM MARATONA E TË DHËNAVE (DATATHON) PËR ÇËSHTJET GJINORE

10-12 korrik 2024  
Tiranë, Shqipëri

Bashkohuni me ne në maratonën e të dhënave për çështjet gjinore! Zhvilloni aftësitë tuaja për të dhënat gjinore, krijoni grupe për të mësuar në mënyrë praktike dhe keni një shans për të fituar çmime për produkte të jashtëzakonshme me të dhëna për çështje gjinore!

- Afati për aplikim:  
**6 maj 2024, 00:00 CET**
- Njoftimi i aplikantëve të suksesshëm:  
**13 maj 2024**
- Workshop para-datathon (me pjesëmarrje fizike):  
**Gershor 2024**
- Datathon 3-ditor:  
**10-12 korrik 2024**
- Mentorim online: **Korrik - Gusht 2024**
- Publikimi i produkteve: **Shtator 2024**
- Gjuha e aktivitetit: **Shqip**



## Pse të merrni pjesë?



Zgjeroni njohuritë tuaja lidhur me rolin e rëndësishëm që luajnë të dhënat gjinore në avancimin e barazisë gjinore.



Zhvilloni aftësi praktike në përdorimin e programeve Excel, Tableau, Canva dhe FlourishChart, për të shqyrtuar, analizuar, interpretuar, vizualizuar dhe komunikuar të dhënat gjinore në mënyrë efektive.



Përmirësoni aftësitë praktike në përgatitjen e një tregimi (storytelling) bindës të bazuar në të dhëna me fokus çështjet gjinore dhe të drejtat e grave.



Krijoni lidhje dhe bashkëpunoni me ekspertë të të dhënave gjinore dhe ekspertë të vizualizimit.



## Kush mund të aplikojë?

Do të pranohen edhe aplikimet individuale, edhe ato në grup. Në rast të regjistrimeve individuale, aplikantët/aplikantet e kualifikuar/a do të renditen dhe caktohen në grupe në bazë të fushave të tyre të interesit dhe niveleve të aftësive.


Këtu janë disa nga kriteret që ju duhet të plotësoni për të marrë pjesë:

- Të jeni shtetas shqiptar
- Të jeni 18 vjec ose më shumë në kohën e regjistrimit
- Të përshtateni, në një prej këtyre roleve: anëtar/e i organizatës për të drejtat e grave dhe organizatës së shoqërisë civile, student/e, gazetar/e, analist/e i të dhënave ose mbrojtës/e i/e përkushtuar i/e çështjeve gjinore, i/e fushës së shkencave sociale, ekonomiks, shkencave të të dhënave apo gazetari.

Të gjitha nivelet e aftësive dhe fushat e shkollimit janë të mirëpritura të marrin pjesë, megjithatë ne rekomandojmë aftësitë e mëposhtme sitë dobishme për të mbështetur një projekt në këtë datathon përfshirë aftësitë për:



Komunikimin dhe gazetarinë



Vizualizimin e të dhënave



Ekspertizën për çështjet gjinore



Studimin/analizën e të dhënave



Inteligjenca Artificiale (Machine learning)



## Cilat janë kriteret për grupin?

Ju mund të formoni grupin tuaj. Grupet nuk duhet të jenë me më shumë se 5 persona. Pasi të jenë përzgjedhur paraprakisht, grupet do të kenë mundësinë të ndryshojnë përbërjen e tyre deri në përfundimin e fazës përgatitore të trajnimit. Pas kësaj, ndryshimet nuk do të jenë më të mundshme.

Mos harroni, jo të gjithë anëtarët/anëtares të grupit duhet të jenë analistë/e të të dhënave. Shumë e shohin të dobishme të krijojnë një grup të përbërë me persona që kanë formim dhe aftësi të ndryshme.



## Si të aplikoni?

Pjesëmarrësit/ pjesëmarrëset duhet të aplikojnë si grupe ose individë duke plotësuar **formularin e aplikimit** deri më 6 maj 2024 00:00 CET.



## Përvoja e datathon

Pjesëmarrësit/et e suksesshëm/suksesshme e suksesshëm do të angazhohen në një trajnim dhe mentorim praktik intensiv 3-ditor për të krijuar produkte mediatike me ndikim që integrojnë të dhënat gjinore në mesazhe mbi barazinë gjinore. Ky aktivitet do të kulmojë me vlerësimin dhe me dhënien e çmimeve për tre produktet kryesore më të mira. Grupet fituese do të përfitojnë një mentorim të thelluar për të përmirësuar më tej punën e tyre, si dhe mbështetje për një produkt profesional multimedial dhe publikimin eventual të produktit.



## Mbështetja dhe përfitimet

Datathoni do të sigurojë materialet e trajnimit dhe shpenzimet për ushqimin për të gjithë pjesëmarrësit/pjesëmarrëset. Për ata/ato që banojnë jashtë Tiranës do të rimbursohen edhe shpenzimet e transportit.

**ORGANIZATORËT:** Instituti i Statistikave (INSTAT), Zyra e UN Women për Shqipërinë dhe programi rajonal për Europën dhe Azinë Gendrore "Making Every Woman and Girl Count".

**KONTAKT:**

Për pyetje apo ndihmë, ju lutemi kontaktoni [eca.genderdata@unwomen.org](mailto:eca.genderdata@unwomen.org).